



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË

Numri i lëndës: 2019:297989
Datë: 11.02.2021
Numri i dokumentit: 01499532

C.nr.1218/2019

GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË – Departamenti i përgjithshëm – Divizioni Civil, Gjyqtari Ahmet Idrizaj, me zyrtaren ligjore Albana Curri, duke vendosur në çështjen juridike të paditësit F. H. nga fshati . . . , Komuna Rahovec, të cilin e përfaqëson i autorizuari Ylli Bokshi, avokat në Gjakovë, kundër të paditurës Komuna e Gjakovës – Drejtoria e Arsimit në Gjakovë, për kompensimin e shpenzimeve të ushqimit dhe të udhëtimit, vlera e kontestit 4,764.20€, pas përfundimit të shqyrtimit kryesor të mbajtur me datë 12.01.2021, në prezencën e të autorizuarit të paditësit dhe në mungesë të të paditurës, me datë 11.02.2021, mori këtë:

A K T G J Y K I M

APROVOHET kërkesëpadia e paditësit F. H. nga fshati . . . , Komuna Rahovec, ashtu që **DETYROHET** e paditura Komuna e Gjakovës - Drejtoria e Arsimit, që paditësit në emër të kompensimit të ushqimit – shujtave për ditët e pranisë në punë, respektivisht 1162 ditë pune të realizuara, të ia paguajë shumën prej 2,324.00€ (pra për çdo ditë pune të realizuar të ia paguajë shumën nga 2€), si dhe për shpenzimet e udhëtimit (për ditët e pranisë në punë, respektivisht 1162 ditë të udhëtimit), të ia paguajë shumën prej 2,440.20€, përkatësisht shumën e përgjithshme prej **4,764.20€**, me kamatë ligjore prej 8% në nivel vjetor, e cila fillon të rrjedhë nga data e marrjes së aktgjykimit 12.01.2021 e tutje, deri në pagimin definitiv, si dhe në emër të shpenzimeve procedurale shumën prej 279,20€, e gjitha këto në afatin prej 7 ditëve nga dita e marrjes së këtij aktgjykimi, e nën kërcënim të përmbarimit.

A r s y e t i m

Paditësi në padi dhe gjatë shqyrtimit kryesor në këtë çështje juridike, nëpërmes të autorizuarit të lartpërmendur të tij, ka parashtruar se i njëjti është punësuar në Shkollën e Mesme të Lartë – Gjinnazi “Hajdar Dushi” në Gjakovë, në cilësinë e mësimitdhënësit në lëndën e fizikës. Të njëjtit në bazë të nenit 36 par. 6 dhe 8 të Kontratës Kolektive të Arsimit Parauniversitar, e nënshkruar në mes të Ministrisë së Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe SBASHK, me datë 11.04.2014 dhe në bazë të nenit 35, par. 5 dhe 7 të Kontratës Kolektive, e nënshkruar në mes të Ministrisë së Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe SBASHK, me datë 18.04.2014, i takojnë nga dy (2) € në ditë, për çdo ditë pune, në emër të ushqimit – shujtës, si dhe shpenzimet e udhëtimit dhe atë 70% të çmimit të biletës të trafikut urban për udhëtim për destinacionin nga vendbanimi i paditësit e deri në vendin e tij të punës, e të cilat obligime duhet të i kryejë e paditura e cila në rastin konkret ka legjitimitet të plotë pasiv.

E paditura edhe përkundër detyrimeve të cilat rrjedhin nga Marrëveshja e Përgjithshme Kolektive e Kosovës dhe Kontrata Kolektive, nuk ka përmbushur obligimet e caktuara që rrjedhin nga të njëjtat, kështu që për këtë arsye paditësi ka qenë i detyruar që të parashtojë padi – kërkesëpadi dhe të kërkojë realizimin e të drejtës së tij subjektive.

I autorizuari i paditësit në fjalën përfundimtare deklarojë se nga provat e administruara, rezulton se kërkesëpadija e precizuar e paditësit është në tërësi e themeltë si për nga baza ashtu edhe për nga lartësia ashtu që gjykatës i propozojë që të njëjtën si të këtillë të e miratojë.

Shpenzimet procedurale i kërkojë dhe atë për pagesën e taksës gjyqësore për padi, në lartësinë prej 40,00€, për përpilimin e padisë vlerën prej 104,00€, si dhe për pjesëmarrje në shqyrtimin kryesor, vlerën prej 135,20€, që përfshin shumën e përgjithshme prej 279,20€.

Gjykata ia ka proceduar këtu të paditurës aktvendimin e datës 13.02.2020 (*për dhënien e përgjigjes së detyrueshme në padi*), padinë dhe provat materiale, të cilat e njëjta i ka pranuar me datë 21.02.2020 (siç vërtetohet nga fletë kthesa e cila gjendet në shkresat e lëndës), mirëpo përgjigjen në padi e ka parashtruar me datë 20.05.2020, përkatësisht pas kalimit të afatit të paraparë ligjor.

Gjykata me propozimin e të autorizuarit të palës aktive në procedurë dhe në kuptim të nenit 423 par. 4 të LPK-së, shqyrtimin kryesor e mbajti në mungesë të të paditurës së ftuar në mënyrë të rregullt, me ç'rast pas analizimit të fakteve juridike relevante të kësaj çështjeje, vlerësimit veç e veç të provave dhe lidhshmërinë e tyre reciproke, e në kuptim të nenit 8 të LPK-së, vërtetojë se kërkesëpadija e precizuar e paditësit, është në tërësi e themeltë dhe si e tillë, u aprovua.

Nga provat e zbatuara, u vërtetua gjendja faktike si në vijim:

Nga Kontratë pune e lëshuar nga Drejtoria e Arsimit në Gjakovë, datë 09.10.2017, e cila kontratë është vërtetuar nën Leg.nr. 108/2021, me datë 14.01.2021, vërtetohet se këtu paditësi në cilësinë e mësimitdhënës të lëndës së fizikës ka punuar në Gjimnazin “Hajdar Dushi” në Gjakovë dhe kohëzgjatja e kontratës së punës është 01.09.2017 – përhershme

Nga Vërtetimi nga Shoqata e Transportit në Gjakovë - në versionin origjinal, e lëshuar nga Kadri Rrahmani – Kryetar, vërtetohet se çmimi i biletës së udhëtimit në relacionin Qifllak – Gjakovë, në një drejtim kushton 1,50€.

Nga Vërtetimi me nr. punues 296, i datës 18.11.2020, i lëshuar nga Gjimnazi “Hajdar Dushi” në Gjakovë, në versionin origjinal, vërtetohet se këtu paditësi – mësimitdhënës i lëndës së fizikës në institucionin e lartpërmendur, ka punuar si në vijim : Viti shkollor 2014/2015 nga dt. 01.01.2015 e deri në përfundim të vitit shkollor – ka vijuar 141 ditë të pranisë në punë; Viti shkollor 2015/2016 – ka vijuar 226 ditë pune; Viti shkollor 2016/2017 – ka vijuar 223 ditë pune; Viti shkollor 2017/2018 – ka vijuar 223 ditë pune; Viti shkollor 2018/2019 – ka vijuar 224 ditë pune; ndërsa në vitin shkollor 2019/2020, deri me datë 29.02.2020, ka vijuar 125 ditë të pranisë në punë, përkatësisht 1162 ditë pune.

Nga Vërtetimi me nr. punues 3589, i datës 24.12.2019, i lëshuar nga Gjimnazi “Hajdar Dushi” në Gjakovë, në versionin origjinal vërtetohet se këtu paditësi – mësimitdhënës i lëndës së fizikës në institucionin e lartpërmendur, prej datës 01.09.2013 e deri me datë 24.12.2019, ka përvojë pune 6 vite e 4 muaj.

Andaj, gjykata në rastin konkret vërteton se në bazë të nenit 35 par. 7 të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë, sipas të cilës dispozitë ligjore në mënyrë decidive është paraparë se: *“Të punësuarve iu sigurohet kompensimi për ushqim gjatë punës, për ditët e pranisë në punë. Vlera e kompensimit të shpenzimit të ushqimit në punë, për një ditë pune është 2 (dy) € për të punësuarit që kanë marrëdhënien e punës primare në institucionet arsimore. Punëdhënësi i cili ka të rregulluar ushqimin e të punësuarve, përmes restaurantit apo kuzhinës, apo ndonjë forme tjetër, nuk ka obligim kompensimin për ushqim”*, ashtu që në rastin konkret gjatë gjithë procedurës provuese, e paditura me asnjë provë materiale nuk ka argumentuar faktin se e ka të rregulluar çështjen e ushqimit të të punësuarve (në vend punimin – objektin ku ka punuar këtu pala aktive në procedurë). Nga ana tjetër nga vërtetimi i lartcituar, për periudhën kohore të kërkuar nga pala aktive në procedurë, rezulton se i njëjti ka punuar në vendin e caktuar të punës për 1162 ditë pune (x 2€ në ditë) atëherë rezulton se kërkesëpadia e tij e precizuar për këtë kompensim, në lartësi prej 2,324€, €, ashtu që e paditura e cila në rastin konkret e posedon legjitimitetin e plotë pasiv është e detyruar që të ia kompensojë së bashku me shpenzimet subsidiare.

Sa i përket kërkesës së paditësit në raport me shpenzimet e udhëtimit nga vendbanimi i tij, fshati . . . – Komuna e Rahovecit, e deri në vend punimin e tij – Gjumnazi “Hajdar Dushi” në Gjakovë dhe duke u bazuar në vërtetimin e lëshuar nga Shoqata e Transportit të Udhëtarëve në Gjakovë, pa datë të lëshimit, vërtetohet se bileta në relacionin e lartcituar, në një drejtim kushton 1,50€, ndërsa në të dy drejtimet 3,00€, ashtu që duke pasur parasysh dispozitën ligjore të nenit 35 par.5, të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë, sipas të cilës është paraparë në mënyrë decidive se: *“Punonjësit arsimor që udhëtojnë në vendbanimet e komunës përkatëse – ku punojnë, i paguhet shpenzimet e rrugës 70% të biletave të trafikut urban”*, ashtu që gjykata në rastin konkret i ka llogaritur ditët e pranisë në punë të paditësit 1162 ditë (1162x2,10€=2,440.20€), atëherë rezulton se të njëjtit në kuptim të dispozitës së lartcituar, për këtë kriter i takon shuma prej 2,440.20€, ashtu që e paditura (e cila në rastin konkret e posedon legjitimitetin e plotë pasiv) është e detyruar që të ia kompensojë këtë shumë paditësit së bashku me shpenzimet subsidiare.

Gjykata vlerëson se Kontrata Kolektive e Arsimit në Kosovë, është në fuqi dhe e zbatueshme në tërë territorin e Republikës së Kosovës dhe se ky dokument kontraktual, prodhon efekt juridik ndaj palëve në procedurë të cilat janë të legjitimuara në kuptimin e legjitimitetit real aktiv dhe pasiv në këtë çështje juridike.

Sipas nenit 8 par. 1, të Ligjit mbi Marrëdhëniet e Detyrimeve të Kosovës (Ligji nr. 04/L – 077), i publikuar në “Gazetën Zyrtare” të Republikës së Kosovës, nr. 16/2012, datë 19.06.2012 (i cili është në implementim nga data 20.12.2012, është paraparë se: *“Pjesëmarrësit në marrëdhënien e detyrimit kanë për detyrë ta përmbushin detyrimin e vet dhe janë përgjegjës për përmbushjen e tij”*. Për më tepër dispozita e nenit 245 par. 1 të LMD-së, ka paraparë se: *“Kreditori në marrëdhënien e detyrimit ka të drejtë që prej debitorit të kërkojë përmbushjen e detyrimit, ndërsa debitori ka për detyrë ta përmbushë atë me ndërgjegje dhe në tërësi, në përputhje me përmbajtjen e tij”*. prej nga rezulton se debitori, përkatësisht e paditura në rastin konkret është e detyruar që kreditores, përkatësisht këtu paditëses në rastin konkret, të ia paguajë vlerën e precizuar të kërkesëpadisë si dhe shpenzimet tjera aksesore, siç më detalisht është vendosur në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Vendimi mbi shpenzimet procedurale u muar sipas nenit 452 par. 1 të LPK-së, me ç’rast paditëses iu pranuan shpenzimet siç në poshtë vijojnë: për pagesën e taksës gjyqësore për padi, shuma prej 40,00€, për përpilimin e padisë shume prej 104,00€ dhe për pjesëmarrje në shqyrtimin kryesor, shuma prej 135,20€, përkatësisht shuma e përgjithshme prej 279,20€.

Nga te lartë cekurat u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË
C.nr.1218/2019, datë 11.02.2021

GJYQ TARI,
Ahmet Idrizaj

UDHËZIM JURIDIK: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afatin prej 7 ditëve, nga dita e marrjes së tij, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, e nëpërmjet të kësaj gjykate.